

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6719
E premte, 30 shtator 2022
çmimi 0.40 €

Lufta në Kosovë dhe rrëzimi i qeverisë Kurti

FAQE 5



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MINISTRI I JASHTËM I ÇEKISË, JAN LIPAVSKY, PO QËNDRON
PËR VIZITË NË KOSOVË

FAQE 2

MINISTRI I JASHTËM ÇEK KA PRITJE TË LARTA PËR LIBERALIZIM TË VIZAVE PËR KOSOVËN



Ministri i Jashtëm i Çekisë, Jan Lipavsky, po qëndron për vizitë në Prishtinë. Ai të enjten është takuar me përfaqësues të institucioneve të Kosovës, me të cilët ka diskutuar për bashkëpunimin mes dy vendeve. Ministri

i Jashtëm çek, në një konferencë të përbashkët për medie me zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi, ka theksuar se pritet e tij janë të larta sa i përket liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës f

AKTUALE



KUVENDI PA KUORUM PËR
VAZHDIMIN E MASAVE EMERGJENTE
PËR ENERGINË ELEKTRIKE

F. 5

KURTI: KOSOVA KA TREGUAR
SUKSES NË BALLAFAQIMIN
ME PANDEMINË COVID-19

F. 7

KËRKOHET BASHKËPUNIM NË
RASTET E HETIMEVE TË PRANUARA
NGA AGJENCIA PËR PARANDALIMIN
E KORRUPSIONIT

F. 6

EKONOMI



EFEKTI NEGATIV I NDIHMËS SOCIALE

F. 8

ATK-ja PUBLIKON BROSHURËN
"KARTA E TATIMPAGUESIT"

F. 8

SPORT



INFANTINO SOT VJEN NË KOSOVË

F. 10



PUSHTETI DHE OPOZITA PËRPLASEN SËRISH NË KUVEND PËR GREVËN NË ARSIM

FAQE 4-5



SONDAZI I KDI-SË: QYTETARËT, BESUESHMËRI TË ULËT NË SISTEMIN E DREJTËSISË

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

MINISTRI I JASHTËM I ÇEKISË, JAN LIPAVSKY, PO QËNDRON PËR VIZITË NË KOSOVË

Ministri i Jashtëm çek ka pritje të larta për liberalizim të vizave për Kosovën

Ministri i Jashtëm i Çekisë, Jan Lipavsky, po qëndron për vizitë në Prishtinë. Ai të enjten është takuar me përfaqësues të institucioneve të Kosovës, me të cilët ka diskutuar për bashkëpunimin mes dy vendeve. Ministri i Jashtëm çek, në një konferencë të përbashkët për medie me zëvendëskryeministrin Besnik Bislimi, ka theksuar se pritjet e tij janë të larta sa i përket liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës



EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Ministri i Jashtëm çek, Jan Lipavsky, ka thënë të enjten se ka pritje të larta që brenda mandatit gjashtëmuor të Presidencës çeke do të finalizohet procesi i liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës.

Presidenca çeke e përfundon mandatin në krye të Bashkimit Evropian më 31 dhjetor të këtij viti. "Është një proces që përbëhet nga çështjet teknike. Bashkimi Evropian do t'i rishikojë shumë shpejt aspektet teknike dhe unë shpresoj shumë që Presidenca çeke do të arrijë deri te një marrëveshje dhe Kosova do të ketë liberalizim të vizave. Është shumë e vështirë ta parashikojmë datën. Pritjet e mia për vendimin janë shumë të larta, dhe kjo është pjesë e agjendës sime politike", ka thënë Lipavsky në një konferencë për medie në Prishtinë. Ai i ka bërë këto deklarata pas takimit që ka pasur me zëvendëskryeministrin e Kosovës, Besnik Bislimi.

Lipavsky ka thënë se i ka kontaktuar edhe disa zyrtarë

nga Holanda për këtë çështje dhe se ata janë pajtuar që të analizohen çështjet teknike dhe më pas ato politike.

Holanda dhe Franca janë dy prej vendeve anëtare të BE-së që kanë qenë skeptike për këtë proces.

Duke iu referuar 13 tetorit, kur çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën do të jetë në rend të ditës në takimin e grupit punues të Këshillit Evropian, Bislimi ka thënë se ajo ditë përbën vetëm nisjen e procesit. "Ky është hap i rëndësishëm, por jo përfundimtar për liberalizim të vizave. Janë edhe pesë procedura, por ne kemi besim të plotë që Republika Çeke do ta shtyjë përpara këtë proces përgjatë presidencës së saj", ka deklaruar Bislimi.

Ai ka thënë se autoritetet e Kosovës i kanë adresuar të gjitha çështjet që i kanë shqetësuar shtetet skeptike për këtë proces.

Kosova pret që liberalizimi i vizave të përfundojë gjatë Presidencës çeke

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim ministrin e Jashtëm të

Republikës Çeke, Jan Lipavsky. Osmani ka theksuar se Çekia është aleate e rëndësishme e vendit tonë, me të cilën ndajmë vlera themelore demokratike dhe përkushtimin për paqe, siguri dhe të ardhmen e përbashkët në familjen euroatlantike.

Fokusi kryesor i takimit ndërmjet presidentes Osmani dhe ministrit Lipavsky ishte çështja e liberalizimit të vizave. Në vazhde të takimeve që ka pasur presidentja Osmani me lidërshpinin çek në Pragë, ka falënderuar ministrin Lipavsky për angazhimin konstruktiv të Çekisë për t'i dhënë fund këtij procesi përgjatë Presidencës çeke.

Presidentja Osmani ka përsëritur qëndrimin se vonesa e liberalizimit të vizave për popullin e Kosovës është një padrejtësi e madhe. "Është jashtëzakonisht e rëndësishme që liberalizimi i vizave të jetë në agjendë, prandaj llogarisim në mbështetjen çeke në këtë aspekt si bartëse e Presidencës së Këshillit të BE-së", ka theksuar presidentja Osmani. Krahas temës së liberalizimit të vizave, presidentja Osmani ka folur edhe për nevojën e avancimit të rrugës evropiane

për vendin tonë. Ajo ka theksuar bashkërendimin e plotë të politikave të jashtme dhe të sigurisë së Kosovës me ato të Bashkimit Evropian si dëshmi e përkushtimit të institucioneve dhe popullit të Kosovës për integrim evropian. Në këtë drejtim, Osmani ka përmendur që Kosova do ta dorëzojë këtë vit aplikimin për statusin e vendit kandidat.

Në lidhje me dialogun me Serbinë, presidentja Osmani ka theksuar se Kosova vazhdon të jetë palë konstruktive dhe se zgjidhja e vetme që i kontribuon paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm është një proces i përqendruar në njohje të ndërsjellë.

I drejtuar nga deputeti Gazmend Gjyshinca, Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë i Kuvendit të Kosovës ka pritur të enjten në takim një delegacion të komisionit homolog të Parlamentit të Republikës së Çekisë, të kryesuar nga kryetari i komisionit, Marek Zenisek. Duke i falënderuar parlamentarët çekë për mbështetjen që vendi i tyre i ka dhënë Kosovës në kohë dhe rrethana të ndryshme, deputeti Gjyshinca i ka njoftuar ata me

zhvillimet aktuale në Kosovë, për arritjet në shumë fusha dhe përparësitë e institucioneve vendore.

Anëtarët e komisionit i kanë informuar mysafirët edhe për hapat e Kosovës në rrugën e integritit evropian, duke vlerësuar nevojën për liberalizimin e vizave për qytetarët tanë, si të vetmit në rajon që privohen nga kjo e drejtë.

Parlamentarët çekë, anëtarë të Komisionit për Punë të Jashtme, kanë shprehur interesimin për zhvillimet aktuale politike në Kosovë, punën e Kuvendit të Kosovës dhe rolin e Komisionit për Punë të Jashtme. Ata kanë konfirmuar vazhdimin e mbështetjes së Pragës zyrtare për Kosovën edhe në vazhdim, si në procesin e liberalizimit të vizave, ashtu edhe për anëtarësimin e saj në organizata të ndryshme ndërkombëtare. Duke çmuar lart marrëdhëniet e deritashme që të dy vendet kanë kultivuar ndërmjet tyre, bashkëbiseduesit janë pajtuar se midis dy shteteve ka mundësi dhe hapësirë për zgjerimin dhe begatimin e këtyre marrëdhënieve, veçanërisht në rrafshin parlamentar.

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Lufta në Kosovë dhe rrëzimi i qeverisë Kurti 2



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Kosova, në luftë me probleme të mbijetesës: Kohën e fundit, dy persona kryesorë në Kosovë, i pari, kryeministri Albin Kurti dhe, e dyta, presidentja e kryeministrit Kurti, Vojsa Osmani, me të madhe po flasin për një luftë të mundshme midis Serbisë dhe Kosovës. Jo se Kosova është e interesuar të bëjë luftë sepse është jashtëzakonisht e angazhuar në luftën e Ukrainës sikur edhe të zgjidhjes së krizave të tjera globale por se Serbia, e armatosur nga Rusia, Kina dhe me bajraktarët (dronët) e Erdoganit, seriozisht po e rrezikon paqen botërore dhe Kosovën. Po flitet për hapjen e "frontit rus" në Kosovë e që ka gjasë të ndodhë për aq sa Kosova do ta hapë "frontin kosovar" në Tanzani.

Kërcënimet për luftë janë manipulative dhe bëhen për ta zhvendosur vëmendjen nga problemet e brendshme me të cilat Kosova, kryesisht për shkak të krizës globale po përballlet, kurse qeveria Kurti 2 nuk po gjen zgjidhje andaj, si gogol për qytetarët po e përdorë luftën të cilën, as nuk e duan dhe as nuk janë në gjendje ta bëjnë dhe nuk kanë pse ta bëjnë. Përveç nëse nuk e kanë pasur si lekturë qeveritare Don Kishotin e Mançës të Servantesit dhe duan të bëjnë luftë me mullinjte e erës. Edhe propaganduesit më të mëdhenj të luftës sikur kryeministri Kurti, presidentja e Kosovës, Vojsa Osmani dhe ndonjë pigmej politik a institucional që mundohen të rriten duka iu llaskucavë udhëheqësve supremë e kanë të qartë se në Kosovë nuk ka luftë edhe në rast se një rreshter i NATO-s, nëse mbetet si mohikan i fundit i NATO-s në Kosovë, në vend të armatimit, në vig të rrobave do i vendosë një palë brekushe me akronim të NATO-s, Serbia nuk do të guxojë të mësyjë Kosovën. Luftë në Kosovë mund të bëhet vetëm me marrëveshje dhe

pëlqim të fuqive të mëdha në rast se për arritjen e një marrëveshjeje politike, kërkohet një luftë e dirigjuar dhe e kontrolluar duke lejuar forcat e njërit apo tjetrit shtet të marrin nën kontroll një territor të caktuar e që me marrëveshje është paraparë t'i takojë shtetit të caktuar. Në rastin konkret, hipotetiksht vlen për Serbinë të cilës do t'i lejohej një ndërhyrje e kufizuar ushtarake për të futur nën kontroll territore të caktuara të Kosovës për të cilat pastaj do të bisedohej për të imponuar një zgjidhje politike. Ndryshe, Serbia as nuk është e gatshme e as nuk ka forcë ta mbajë nën okupim një territor të Kosovës, nëse nuk e ka pëlqimin e fuqive të mëdha. Në anën tjetër, në qeverinë aktuale Kurti 2 nuk mund ta gjeni asnjë ministër që do të jetë i gatshëm të luftojë në mbrojtje të Kosovës, sepse nuk e kanë mbrojtur kur ka qenë koha (disa për shkak të moshës, disa për shkak të prapancës së madhe, disa se me mish dhe me shpirt kanë qenë kundër luftës dhe UÇK-së) e që ta mbrojnë tani! Nëse në këtë qeveri keni ministra që haptazi janë kundër UÇK-së duke e krahasuar me mercenarët, nëse në qeveri keni ministra që haptazi e shfaqin gëzimin për burgosjen e udhëheqësve kryesorë të UÇK-së e pas luftës udhëheqës kryesorë të institucioneve të Kosovës, atëherë është joserioze të flitet për një luftë në Kosovë por me shumë mund dhe duhet të flitet për karrieristë dhe përfitues politikë, në saje të sakrificave të të tjerëve. Nëse luftën e konsideroni si luftë virtuale me play-station, folni për luftën. Prandaj, jam i sigurt se në Kosovë nuk do të ketë luftë me Serbinë (ushtarake) kurse lufta politike thuaja do të jetë e përhershme. Gjysma e qeverisë ka shtetësi të dyfishtë apo të trefishtë, janë biseksuale politikë dhe qeveritar;

në rastin e rrezikut më të vogël e kanë strehën e sigurt për kokën dhe prapancën e tyre. Ma gjeni një deputet nga pozita (hiç këtu ata që kanë luftuar por se tani, as moshë e as shëndeti nuk ua mundëson një përballje ushtarake) që do të bënte një sakrificë, qoftë edhe heqja e një meditjeje apo shpenzimet për karburante, e lëre më për luftë. Lufta është sport shumë i rëndë siç thotë, me të drejtë, Ramush Haradinaj që asnjëherë, personalisht dhe familjarisht nuk e ka ndalë luftën me Serbinë, deri në kohën kur Kosova u lirua e jo u çlirua! Kosova po përballlet me probleme të natyrës ekzistenciale si; gjendja e vështirësuar ekonomike, një arsim analfabetar, një shëndetësi që mbështetet në fall sepse ministri është i tillë, probleme të furnizimit me rrymë sepse e kemi një ministër diletant, probleme me punësim sepse e kemi një ministër që shumë angazhohet për punësim në Utar Pradesh (Indi), se në Kosovë, probleme me politikë të jashtme sepse e kemi një ministër që vuan nga fatamorgane (mendon se vërtet është ministër për punë të jashtme), një ministër për kulturë kur komunikimi ndërinstitutional dhe debatet në Kuvendin e Kosovës janë të barazvlefshëm me një prostitucion intelektual dhe ministri të tjera, aspak mbi nivelin e këtyre që i përmenda. Përkundër të gjithave, nuk ka asnjë dorëheqje morale e lëre më materiale apo shkarkim, jo se jo. Faktori ndërkombëtar vazhdimisht po deklaron se në Kosovë nuk do të ketë luftë në kohën kur ata janë zotë e luftës dhe të paqes; kur duan e bëjnë luftën dhe kur duan e inprovizojnë paqen, deri në luftën e radhës. Fleni desh e dathë sa i përket rrezikut të luftës dhe, në mungesë të rrymës, nëse nuk keni mundësi të blini 10 metra dru (si zëdhënësi i KEK-ut), dhe shkaku se

tërë rrymën po e shpenzojnë xhoistikët, përdorni një metodë tradicionale për t'u ngrohur e që me shumë sukses e kanë përdorur indianët e Amerikës, fleni bashkë dhe fërkohuni bashkë, pozitë dhe opozitë!

A do të rrëzohet qeveria Kurti 2: Gjithashtu, për t'i ikur përgjegjësisë për gjendjen e rëndë e për të cilën nuk e ka tërë përgjegjësinë qeveria Kurti 2 (një pjesë e përgjegjësisë është për shkaqe globale, një pjesë për shkaqe të trashëguara nga paraardhësit kurse pjesa e mbetur është e qeverisë Kurti 2) në vazhdimësi po flitet nga rreziku i rrëzimit të qeverisë Kurti 2. Më së shumti flitet nga ata që aksidentalisht janë bërë deputetë, ministra apo bartës të posteve që, në rrethana normale nuk do të kishin mundësi as t'i nuhasnin ato poste. Flitet për konspiracione e pallavra tjera në kohën, që nga koha e Ali Bungut e deri më sot Kosova nuk ka pasur opozitë më të lodhur, të mbaruar fare dhe krejtësisht impotente për ta rrëzuar qeverinë. Madje, e them me përgjegjësi se, as LDK-ja e as PDK-ja nuk e kanë as gatishtësinë më të vogël ta rrëzojnë qeverinë Kurti 2, edhe nëse do ta kishin mundësinë. Politikisht, asnjë parti serioze nuk do të ishte aq e marrë që ta merr qeverinë dhe qeverisjen në këtë kohë dhe në këto kushte. Kjo do të ishte një vetëvrasje politike ndërkaq që politikanët duan të jetojnë dhe qeverisin gjatë. Hipotetiksht mund të flitet për një koalicion, ose tash (nëse ua shtrëngojnë lakun për nënshkrimin e një marrëveshjeje me marrjen e vendimeve të vështira), ose pas zgjedhjeve, nëse deri atëherë nuk nënshkruhet marrëveshja. Mendoj se një koalicion i mundshëm mund të jetë midis LV-së dhe LDK-së me ç'rast Lista Guxo do të shkonte në recycle been dhe mbetjet e grimcosura si dhe hiri i krematoriumit politik do t'i bashkohet LDK-së. Në rrethana

aktuale LV-ja kurrë nuk do të bëjë koalicion me PDK-në. Albin Kurti ka fituar me 51% të votave dhe nuk është e drejtë dhe e moralshme të rrëzohet nga pushteti. Mirëpo, e vërteta është se Albin Kurtin mund ta rrëzojë Albin Kurtin dhe tjetër mundësi nuk ka. Nuk ka as vullnet nga opozita ta bëjë këtë dhe opozita aktuale nuk do të pranojë pushtet përmes rrëzimit të qeverisë Kurti 2. Mirëpo, më këta deputetë që i ka LV-ja dhe me këta ministra, tepër gjatë i ka shkuar. Situata vetëm sa po bëhet më e rëndë e që po i bëhet si gur për qeverinë aktuale. Nuk e besoj se bisedimet me Serbinë apo marrëveshja eventuale, qoftë edhe më e pafavorshme për Kosovën do ta nxisë opozitën ta rrëzojë qeverinë Kurti 2 aq më parë që ndërkombëtarët nuk duhet të shpenzojnë shumë mund dhe para për ta bindur opozitën që të notojë në të njëjtat valë me pozitën. E kanë recetën e provuar dhe stërpërdorur çdo herë kur kanë nevojë. Qind për qind kanë qenë të suksesshëm. LV-ja e pozitës është e kundërta e opozitës së dikurshme të LV-së; si opozitë kundërshtonin çdo gjë, si pozitë arsyetojnë çdo gjë! Kjo i kushton shumë Albin Kurtit. Albin Kurtin dhe qeverisjen e tij e rrezikojnë injorantët e tij, qoftë deputetë apo ministra që janë shpërndarë, si metastaza në të gjitha porët e shoqërisë dhe sistemit. Gabimi kryesor ka qenë se Albin Kurti, pasi ka fituar aq shumë pushtet nuk ka pasur mbushje partiake cilësore për ta mbushur këtë pushtet prandaj është mjaftuar me arnimin e posteve të një shtofi kualitativ, me arna të stërpërdorur. Po kjo ishte zgjidhja e Albin Kurtit dhe këta mund t'i hanë kokën politike. Po e them se Albin Kurtin mund dhe do ta rrëzojë vetëm Albin Kurti. Sa për LDK-në e sotme dhe PDK-në e sotme, Albin Kurti mund të fle pa asnjë brengë për humbje të pushtetit. Kurse, llaskucët që e rrethojnë dhe himnizojnë Albinin se po e palos këtë dhe këtë, në fund do të bëhen llaskucë të të tjerëve. Një herë llaskuc, gjithmonë llaskuc! Çka po donë Bizmarku në Kosovë: Gjermanët e Sholcit po mundohen ta marrin flamurin e zgjidhjes së çështjes së Kosovës duke barazuar Kosovën dhe Serbinë se të dyja vendet duhet të marrin vendime të vështira. Si Serbia kriminale në kohën e Millosheviqit, super kriminale në kohën e Vuçiqit sikur Kosova që e ka pësuar dhe po e pëson nga ky kriminalitet dhe superkriminalitet i regjimit të Serbisë. Fillimisht e hedhin në treg kornizën e re të bisedimeve dhe marrëveshje si ajo midis dy gjermanive (tash është një Gjermani) dhe, kur ka kundërshtime distancohen nga autorësia. Tash, ambasadori i Gjermanisë në Kosovë thotë se duhet të formohet Zajebnica por se ajo nuk mund të jetë Republikë e tretë në Kosovë. Mbase e ka ndonjë propozim se pas dhjetë (10) vjetëve kjo Zajebnicë mund të jetë si njësi federative apo konfederative e unionit Serbi - Kosovë! Shajzen është kjo punë!



KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË PLENARE

Pushteti dhe opozita përplasen sërish në Kuvend për grevën në arsim

Greva në arsim ka përplasur sërish në Kuvend pushtetin dhe opozitën. Lideri i PDK-së, Memli Krasniqi dhe ai i AAK-së, Ramush Haradinaj, e kanë akuzuar kryeministrin Albin Kurti për kokëfortësi dhe urrejtje ndaj mësimdhënësve. Derisa Krasniqi ka vlerësuar se Kurti është duke investuar në ndarjen e shoqërisë në dy taborë, Haradinaj i ka thënë kryeministrit se mësimdhënësit do t'ia tregojnë qejfin kur të vijë kohë. Ndërsa kryeministri Kurti, duke iu referuar kërkesave të sindikalistëve të arsimit, ka thënë se çmimet nuk janë rritur vetëm për mësimdhënësit

Lirim GECI

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Greva në arsim ka përplasur sërish pushtetin dhe opozitën. Të enjten në Kuvendin e Kosovës opozita ka fajësuar pushtetin për kryeneçësi në raport me grevën në arsim, e cila më së shumti është duke u kushtuar nxënësve.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka deklaruar se kryeministri Albin Kurti ka menduar vetëm si të dalë triumfues dhe i panënshtuar ndaj kryetarit të SBASHK-ut, Rahman Jasharaj. Krasniqi ka theksuar se Kurti në këtë situatë ka vazhduar logjikën e konfrontimit dhe jo të zgjidhjes së situatës. "Problemin specifik që kërkon zgjidhje e ka shndërruar në zgjidhje të tij për problemet e gjithanshme me të cilat ballafaqohemi si vend. Ka zgjedhur të merret me lavdi politike duke iu dëshmuar militantëve dhe vartësve të tij se çka do të thotë me qenë kokëfortë

e i panënshtuar ndaj Rahman Jasharajt dhe mësimdhënësve. Pra, për të nuk është me rëndësi dëmi, as ai direkt e as koleteral, as nxënësit dhe mësimdhënësit. Me rëndësi është fundi, sepse Albin Kurti e ka traditë politike të mendojë për fundin pa i llogaritur pasojat e as personazhet. I tillë ka qenë gjithmonë. Të tillë janë ata politikanë që politikën e shohin jo si përmbushje të përgjegjësiive ndaj qytetarëve, por si përmbushje të egrove të pushtetarëve", ka thënë ai. Më tutje, Krasniqi ka thënë se që dy vjet mandat të Kurtit, investimi më i madh i tij është ndarja e shoqërisë në dy taborë. Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, e ka kritikuar qeverinë Kurti për grevën në arsim, duke theksuar se shumica e mësimdhënësve në Kosovë janë edhe prindër dhe, sipas tij, nuk ka logjikë të mendohet se ata me qëllim nuk po duan të kthehen në punët e tyre për të dhënë mësim. "A besoni dikush se ata

mësimdhënës prej qejfit kanë ndenjur në shtëpi e nuk kanë shkuar për të dhënë mësim. Kush mund ta besojë këtë? Kjo pyetje besoj se jep një përgjigje të drejtë. Nga viti 2018 pagat nuk janë ngritur dhe vazhdimisht është shtrenjtuar jeta. Jo vetëm për mësuesit, jo vetëm për të punësuarit në sektorin publik, por edhe për të punësuarit në sektorin privat", ka thënë Haradinaj. Në momentin kur Haradinaj ka folur për shtrenjtimin e produkteve bazë, ka ndërhyrë ministri i Financave dhe Transfereve, Hekuran Murati, i cili e ka "detyruar" Haradinajn ta ndërpresë fjalën. "Hajde qu, urdhëro", i ka thënë Haradinaj dhe është larguar nga foltoja. Pas largimit të Haradinajt nga foltoja, ka reaguuar kryeparlamentari Glauk Konjufca, i cili ka kërkuar nga ministrat ta respektojnë fjalën e deputetëve, por lideri i AAK-së nuk ka pranuar ta vazhdojë fjalën.

Kurti: Çmimet nuk janë rritur vetëm për mësimdhënësit

Pas këtyre kritikave, ka reaguuar kryeministri Albin Kurti, i cili ka theksuar se ka ofruar zgjidhje për grevën në arsim. Kurti ka thënë se çmimet nuk janë rritur vetëm për mësimdhënësit. "Më 1 shtator e kemi takuar kryetarin e BSPK-së. Ua kemi ofruar triumfin ta publikojmë bashkë pakon e përbaljes me inflacion. Unë kam dashur të bëhen pjesë e fitores. Është rezultat i trynisë së tyre. E kanë pëlqyer, por prapë nuk e kanë pranuar. Pasi kanë dalë nga takimi nuk e di me kë janë takuar. U ka pëlqyer pako, por nuk e di më pas. Deputeti Krasniqi tha se ky është një problem specifik. Nuk është problem specifik, prandaj s'mund ta trajtoj në mënyrë specifike. E kam takuar shumë herë BSPK-në, SBASHK-un dhe Këshillin Grevist. Ata thoshin se janë rritur çmimet, por këto çmime nuk janë rritur specifikisht për mësuesit e arsimtarët. Nëse në markete do të shkruante 'çmimet e rritura vlejné për mësuesit', do të ishte problem specifik", ka thënë Kurti, duke shtuar se mësimdhënësit janë kategori e veçantë, por problemi nuk është specifik. Kurti ka thënë se pagat do të rriten, por ka theksuar se nuk ka

qenë zotim i tij. "E ky është dallim i madh. Mua duhet të më matni karshi zotimeve që kam bërë, e jo të opozitës. Le të flasim për sundimin e ligjit, për drejtësi, sa kemi arritur të bëjmë punësim e në çfarë procese ndodhemi. Ashtu mund të matet qeverisja jonë e jo me rritje të pagave. Megjithatë, pagat do të rriten. Sa për sqarim është e vërtetë se ministri Murati i ndërhyri në fjalë deputetit Haradinaj, mirëpo ai nuk e ka fyer. Në momentin kur Haradinaj tha se nga viti 2018 nuk janë rritur pagat, ministri Murati tha sa pagat janë rritur. Pra, pagat janë rritur 4 për qind apo 14 euro. E kuptoj se s'mund të ndërhyjmë, por duhet ta pranojmë se ndërhyrja është dukuri në Kuvend e jo përjashtim. Unë nuk flas për kurrfarë armiq të brendshëm", ka thënë Kurti.

Krasniqi dhe Haradinaj s'i ndalin kritikën ndaj Kurtit dhe ministrave të tij

Ndaj fjalimit të Kurti kanë replikuar Haradinaj dhe Krasniqi. Fillimisht Haradinaj ka thënë se sa herë që flet nga foltoja, pengohet nga qeveria. Më tutje, Haradinaj i është drejtuar kryeministrit Kurti me "ta tregojnë qejfin mësimdhënësit

Kuvendi pa kuorum për vazhdimin e masave emergjente për energjinë elektrike

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Kuvendi i Kosovës, në mungesë të kuorumit, nuk ka marrë vendim të enjten për zgjatjen e masave emergjente për furnizim me energji elektrike ashtu siç parasheh vendimi i Qeverisë së Kosovës.

Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se prej 78 deputetëve të pranishëm në Kuvend, 58 deputetë kanë votuar për. “Nuk ka kuorum për të marrë vendim”, ka thënë Konjufca.

Gjatë seancës plenare shefja e grupit parlamentar e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, ka propozuar mocion procedural për ta futur si pikë të rendit të

ditës këtë vendim. “Propozojmë vendimin e qeverisë për zgjatjen e masave emergjente për furnizim me energji. Qëllimi i këtij vendimi është që këto masa të zgjaten edhe për 30 ditë të tjera. Duke ditur rëndësinë e këtij vendimi, kërkojmë që ky vendim të futet në rend dite sot dhe të votohet”, ka thënë Kusari-Lila.

Kundër këtij mocioni ishin PDK-ja dhe LDK-ja. Deputeti i PDK-së, Ferat Shala, ka thënë se është hera e katërt që sillet në këso forme një mocion për çështjen e energjisë. E deputeti i LDK-së, Driton Selmanaj, në emër të grupit parlamentar të kësaj partie ka thënë se abstenojnë.



kur të vjen vakti”. “Ky ‘good guy’ i yni këtu është i keqtrajtuar, i urrejtur dhe u rrit duke urrejt. Prej që është bërë regjim u kthye duke urrejt ata që e kanë pru këtu ku është. I ka urrejt regjimet, prej që është bërë regjim vet, s’po ka kanë me urrejt më ia ka nis me i urrejt ata që e kanë pru këtu, armiqtë e brendshëm. Kush janë armiqtë e brendshëm, sindikatat, mësuesit me i urrejt dhe me i mposhtur. Ta tregojnë qejfin kur

vjen vakti”, ka thënë Haradinaj. Ndërsa Memli Krasniqi në replikë me Kurtin i ka akuzuar ministrat e tij se përparësi e kanë lëvdatën ndaj shefit të tyre në vend të punës së tyre në fushat përkatëse. “Mirë që dole kryeministër, se ndonjëherë po fshihesh pas këtyre argatëve tu. Mësoji ka pak se nuk kanë nevojë me t’u dëshmuja ty, se po e sheh populli dëshminë e tyre, e s’kanë nevojë ty që të dëshmojen sa lojalë janë,

se të vetmen garë që e bëjnë këta është, se cili po të hyn në qejf më shumë. Në vend se me ba garë që me qitë diçka në dritë në këtë vend, garën e kanë kush po e lëvdon Albinin më shumë”, ka thënë Krasniqi, duke shtuar se greva është problem specifik meqë nuk është vetëm e mësimdhënësve, por edhe e sektorëve të tjerë. Ai ka thënë se disa punëtorë të administratës dalin në punë për shkak të

“shantazhit nga Kurti”. Po ashtu, Krasniqi ka ironizuar edhe me moton e dikurshme të partisë së Kurtit në zgjedhje që e kishte dikur: “Erdhi dita”. “Thoshit erdhi dita. Kryeministër, dita shkoi gati e ju hala nuk e keni filluar punën. Mbrëmja është duke ardhur. Çu puno najsen. Dije që ora katër pasdite është e ju ende asgjë nuk keni bërë”, ka thënë Krasniqi. Në debatin për grevën e arsimit

është përfshirë edhe ministrja e Arsimit, Arbërie Nagavci, e cila ka kërkuar të fillojë mësimi. Edhe ndaj kësaj deklarate ka reaguar kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, i cili ka kërkuar dorëheqjen e Nagavcit. “Ju po bëni thirrje që mësimi të fillojë. Ju jeni në qeveri për të bërë zgjidhje, jo thirrje. Ju duhet të jepni dorëheqje që i keni mbyllur në shtëpi 320 mijë fëmijë”, ka thënë Krasniqi.

Komuna e Skenderajt pranon donacion një kamion të zjarrfikjes

Skenderaj, 29 shtator - Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit në Skenderaj ka pranuar një kamion të zjarrfikjes dhe shpëtimit, donacion nga Gjermania, për të cilin kontribut të madh ka dhënë

Besnik Miftaraj, konsull në Konsullatën e Përgjithshme në Shtutgart të Gjermanisë. Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, dhe shefi i Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, Liman Geci,

janë shprehur tejet falënderues ndaj konsullit Miftaraj për kontributin dhe angazhimin që ShZSh në Skenderaj të pajisjet me kamion, i cili do të ndihmojë për kryerjen efikase të aktiviteteve të këtij shërbimi.



Tri komunitat regjionale nënshkruajnë marrëveshje për menaxhimin e integruar të mbeturinave



MITROVICË, 29 SHTATOR - Komuna e Mitrovicës, së bashku me dy komunitat e tjera të regjionit, atë të Vushtrisë dhe të Skenderajt, kanë nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit ndërkomunal për iniciimin e menaxhimit të integruar të mbeturinave. Nënshkruer të kësaj marrëveshje ishin nënkryetari i komunës së Mitrovicës, Arian Tahiri, kryetari i komunës së Vushtrisë, Ferit Idrizi dhe kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura. Me rastin e ceremonisë së nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje ishin të pranishëm edhe përfaqësues nga GIZ-i, kryesuesja e Kuvendit Komunal të Mitrovicës, Vesa Broja, kryesuesja

e Kuvendit të Vushtrisë, Melihate Basholli dhe kryesuesja e Kuvendit të Skenderajt, Adelina Spahiu, drejtorë të drejtorive komunale për mbrojtje të mjedisit si dhe zyrtarë të tjerë komunalë. Qëllimi kryesor i memorandumit të mirëkuptimit është krijimi i kushteve bazë për komunitat drejt themelimit të sistemit regional për menaxhimin e integruar të mbeturinave përmes bashkëpunimit ndërkomunal. Vlen të potencohet se draftmemorandumi është përgatitur dhe mbështetur nga GIZ-i gjerman, i cili vazhdimisht u ofron përkrahje komunave për përmirësimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave.

Kërkohet bashkëpunim në rastet e hetimeve të pranuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Ushtuesi i detyrës i Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka pritur në takim drejtorin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Yll Buleshkaj, i cili ishte i shoqëruar nga drejtori i Departamentit për Luftimin e Korrupsionit në këtë Agjenci, Blerim Kelmendi. Thellimi i bashkëpunimit ndërinstitutional, tejkalimi i sfidave dhe përmirësimi i punës së përbashkët, veçanërisht

avancimi i komunikimit gjatë zbatimit të kërkesave ligjore, unifikimi i praktikave nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta, si dhe diskutimi i modaliteteve për zbatimin sa më efikas të legjislacionit të ri për luftimin e korrupsionit, ishin disa nga çështjet përmbajtësore të cilat janë diskutuar në takimin e përbashkët ndërmjet ushtuesit të detyrës së Kryeprokurorit Kelmendi dhe drejtorit Buleshkaj.

Me këtë rast, u.d. Kryeprokurori i Shtetit, Besim Kelmendi, ka theksuar përkushtimin, nevojën dhe rëndësinë e madhe të bashkëpunimit të dyanshëm, sidomos për aspektet që kanë të bëjnë me rastet e hetimeve të pranuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit. Bashkëbiseduesit u pajtuan që të ketë angazhim dhe bashkëpunim të shtuar për përmbushjen së më efikase të përgjegjësi ligjore të institucioneve përkatëse.



Në sheshin "Fehmi Lladrovci" mbahet karvani shëndetësor



Drenas, 29 shtator - Për herë të parë në sheshin "Fehmi Lladrovci" në Drenas është mbajtur karvani shëndetësor me moton "Përhëndetje" i organizuar nga AQH e financuar nga Agjencia zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Në këtë aktivitet ka marrë pjesë edhe kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, me

drejtorë të drejtorive komunale. Ai i ka përgëzuar organizatorët për mbajtjen e kësaj ngjarjeje dhe ka vlerësuar se një organizim i tillë është mjaft i qëlluar, sepse ndikon te qytetarët për t'u informuar për shëndetin e tyre. Lladrovci ka thënë se komuna e Drenasit mbetet e përkushtuar për të bashkëpunuar me aktivitete të tilla të cilat i

ndihmojnë qytetarët në kujdesin e tyre ndaj shëndetit. Aktiviteti "Përhëndetje" është mbajtur në tendat e improvizuara në sheshin "Fehmi Lladrovci" dhe përmes profesionistëve shëndetësorë janë ofruar informata mjaft të rëndësishme mbi shëndetin sikurse janë: aktiviteti fizik, duhani, alkooli, mbipesha dhe ushqyeshmëria.

Gjilanit i shtohen dy çerdhe të reja

GJILAN, 29 SHTATOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka bërë me dije se Gjilanit do t'i shtohen edhe dy çerdhe të reja. Ai ka thënë se në javën e ardhshme do të nisë

ndërtimi i çerdes në Gjilan dhe asaj në Dobërçan. "Në financim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë do të shtohen dy çerdhe në Gjilan. Edukimi i

hershëm, rritja e përfshirjes të sa më shumë fëmijëve në të dhe çerdhjet e reja janë disa nga zotimet tona që po realizohen", ka thënë kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni.



Kurti: Kosova ka treguar sukses në ballafaqimin me pandeminë Covid-19

Prishtinë, 29 shtator - Sukseset dhe sfidat në fushën e promovimit dhe të edukimit shëndetësor në Kosovë janë bërë me dije nga kryeministri Albin Kurti në hapje të Konferencës së Tretë Rajonale për Promovim dhe Edukim Shëndetësor.

Në fjalën e tij të rastit, kryeministri Kurti ka thënë se Kosova ka treguar sukses në ballafaqimin me pandeminë Covid-19. Gjithashtu, ai ka thënë se ky sukses na jep një mundësi ideale për të reflektuar mbi rëndësinë e promovimit dhe edukimit shëndetësor. Një pjesë e madhe e këtij suksesi, ka

thënë ai, ka qenë pikërisht për shkak të efikasitetit në promovim dhe edukim. "Aktualisht, një prej sfidave kryesore të institucioneve shëndetësore në fushën e promovimit dhe edukimit është të gjejmë një mënyrë se si ta përsërisim suksesin tonë gjatë pandemisë në luftimin e sëmundjeve të tjera", ka thënë kryeministri në këtë konferencë dyditore.

Ai ka shtuar se sfida kryesore në këtë drejtim është se si të edukojmë qytetarët që t'i bëjnë ndryshimet e duhura në jetën e tyre të përditshme sot, për të parandaluar sëmundje të rënda kronike që mund të

zhvillohen 10 ose 20 vjet më vonë. "Një zgjidhje e suksesshme e këtij problemi do të shpëtonte qindra jetë njerëzish dhe do të kishte një impakt të madh pozitiv në shëndetin publik afatgjatë", ka theksuar ai.

Në përmbyllje të fjalës së tij, kryeministri Kurti ka theksuar se agenda e kësaj konference të organizuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, në bashkëpunim me Asociacionin Kosovar për Promovim dhe Edukim Shëndetësor "Mjediset e shëndetshme", dhe përkrahur nga zyra e OBSH-së në



Prishtinë, është rëndësi të lartë si në aspektin jashtëzakonisht e pasur dhe teorik, po ashtu edhe në përfshinë tema që janë me aspektin praktik.

Sondazhi i KDI-së: Qytetarët me besueshmëri të ulët në sistemin e drejtësisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të enjten konferencë për medie në të cilën janë shpalosur rezultatet e hulumtimit të opinionit publik të realizuar gjatë periudhës 10 deri më 18 shtator të këtij viti, që reflekton këndvështrimet e qytetarëve të Kosovës mbi reformën në sistemin e drejtësisë.

Gjatë prezantimit të të dhënave hulumtuese i KDI-së, Arbër Thaçi, ka theksuar se sondazhi prej 6 pyetjeve është realizuar me metodën e omnibusit, në të cilin kanë marrë pjesë 1065 respondentë të moshës mbi 18 vjeç nga i gjithë territori i Kosovës.

Me këtë sondazh është synuar të

nxirren perceptimet dhe disponimi i qytetarëve për nevojën e reformës në sistemin e drejtësisë, besueshmërinë e qytetarëve në organet e drejtësisë, çështjen e vetëgjyqjes dhe Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë si dy procese që janë në qendër të reformës në drejtësi.

Në pyetjen e parë drejtuar qytetarëve, lidhur me atë se sa i besojnë ata sistemit të drejtësisë në Kosovë, ku vlera 1 është aspak dhe 5 plotësisht, mesatarja e besueshmërisë ka rezultuar të jetë 3.14.

Në pyetjen e radhës drejtuar qytetarëve se çfarë do të thotë për ata reforma e thellë në drejtësi, për 52.6 % dhe 47.9 % të qytetarëve reforma fokusohet kryesisht në rritje të kualitetit të gjykatave,

respektivisht për qytetarët reforma përfaqëson gjyqtarë profesionalë dhe gjykata të pavarura.

Ndërsa për 40.7 % të qytetarëve të anketuar reforma në drejtësi do të thotë luftë më efektive kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në anën tjetër, 39.4 % dhe 36.4 % e qytetarëve e shohin reformën në drejtësi në zgjidhjen më efektive të rasteve gjyqësore dhe qasje më të lehtë në sistemin e drejtësisë.

Në pyetjen pasuese qytetarët janë pyetur se a mendojnë që sistemi i drejtësisë mund të reformohet. Lidhur me këtë, një përqindje shumë e lartë e qytetarëve prej 70.8 % janë të mendimit se reforma në drejtësi është e mundur, për dallim nga 19.3 % që mendojnë se sistemi i drejtësisë nuk mund të

reformohet.

Kur janë pyetur për çështje konkrete të reformës në drejtësi si çështja e vetëgjyqjes, Thaçi ka theksuar se kjo pyetje ka pasur për qëllim të nxjerrë në pah se sa e kuptojnë qytetarët çështjen e vetëgjyqjes në drejtësi. Nga rezultatet e sondazhit del se procesi i vetëgjyqjes për përqindjen më të lartë të qytetarëve, konkretisht mbi gjysmën e tyre prej 53.2 % dhe 50 %, nënkupton vlerësimin e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, respektivisht vlerësimin e prejardhjes së pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në anën tjetër, për një shumicë të konsideruar të qytetarëve (49.7 %), procesi i vetëgjyqjes nënkupton vlerësim të aftësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kur janë pyetur se sa e përkrahin ata vetëgjyqjen në sistemin e drejtësisë, shumica e qytetarëve, konkretisht 73.7 % e tyre janë deklaruar në mbështetje të këtij procesi, për dallim të 13.1 % të qytetarëve që nuk janë dakord që ky proces të ndodhë.

Në pyetjen e fundit pjesë të këtij sondazhi qytetarët janë pyetur edhe për çështjen e Byrosë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së pajustificueshme që është, po ashtu, pjesë e reformës në sistemin e drejtësisë. Konkretisht për këtë çështje qytetarët janë pyetur se a e përkrahin idenë e krijimit të një organi të tillë. Lidhur me këtë, 76.6 % e të anketuarve kanë shprehur mbështetje për krijimin e Byrosë Shtetërore, me 11.8 % e tyre që nuk e mbështesin një gjë të tillë.

Gjashtë raste të reja me Covid

Prishtinë, 29 shtator - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët, pas

106 testimeve, janë konfirmuar gjashtë raste të reja me Covid-19.

Sipas raportit të MSh-së, dhjetë persona janë shëruar nga Covidi.

Raste aktive janë 37. Brenda 24 orëve janë vaksinuar 34 persona.



Efekti negativ i ndihmës sociale

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Artan Mehmetaj është mbajtës i një familjeje nëntanëtarëshe, nuk ka punë të rregullt, por përfiton nga ndihmat që ia jep shteti.

Ky 35-vjeçar nga Prishtina merr 120 euro në muaj asistencë sociale dhe nga 10 euro për secilin nga shtatë fëmijët që ka - në total 190 euro. Për t'i siguruar këto mjete atij i duhet ta plotësojë një kusht: të mos ketë të punësuar asnjë anëtar të familjes. Ai angazhohet vetë kohë pas kohe, duke bërë punë të ndryshme krahu, por pa u regjistruar diku punëtor. "Unë kam dëshirë të kem një punë me kontratë, por me një pagë më të lartë, jo 300 euro, nuk kam llogari, sepse dal nga asistencë sociale. Kështu po punoj nganjëherë, plus asistencë, e po bëhet diçka", thotë Mehmetaj.

Teksa flet për "Radion Evropa e Lirë", ai tregon se ka muaj që fiton më shumë se 300 euro nga puna që bën, por se ka edhe periudha që nuk arrin as gjysmën e kësaj shume. Si punëtor i paregjistruar, ai nuk paguan tatime për shtetin e as kontribute për pensionin e tij. Si ai, që refuzon punën e rregullt për ta përfituar asistencën sociale, duket se ka një numër të madh të qytetarëve në Kosovë.

Fidan Hallaqi, i cili zotëron dy kompani në Prishtinë - një në sektorin e transportit dhe një në atë të hotelierisë - thotë se përballet shpesh me punëkërkuar që nuk duan kontratë të rregullt.

Hallaqi thotë se paga mesatare që ofron është 460 euro në muaj.

Ai tregon se në çdo konkurs që hap, 30 deri në 50 për qind e punëkërkuarve që ftohen për intervistë janë përfitues të asistencës sociale. "Ne u ofrojmë atyre afat shtesë për të vendosur nëse duan të shkëputen nga përfitimet e skemës sociale dhe të punësohen. Por, nuk e kemi pasur as edhe një rast të tillë që ka vendosur të largohet nga skema sociale për punësim me kontratë të rregullt", thotë

Hallaqi për "Radion Evropa e Lirë".

Ky fakt, shton ai, pamundëson punësimin e tyre pasi, siç thotë, nuk mund t'i ekzekutojë pagat dhe detyrimet e tjera me transaksione joformale.

Të dhënat e Agjencisë së Statistikave tregojnë se papunësia në Kosovë vitin e kaluar është sjell mes 20.5 për qind dhe 25.8 për qind. Sipas kësaj agjencie, 40.8 për qind e të punësuarve kanë kontratë të përhershme për punën e tyre kryesore, ndërsa 59.2 për qind kanë kontratë të përkohshme.

Detyrimet e kontratës

Kontrata e punës nënkupton që punëdhënësi është i detyruar ta paraqesë të punësuarin në Administratën Tatimore të Kosovës dhe në institucionet e tjera që menaxhojnë dhe administrojnë skemat e obligueshme pensionale dhe skemat e tjera.

Të gjithë të punësuarit me kontratë paguajnë 10 për qind kontribute pensionale: pesë për qind paguhen nga punëdhënësi, kurse pesë për qind ndahen nga paga e të punësuarit.

Tatimi mbi të ardhurat personale sillet nga katër deri në 10 për qind varësisht nga shuma e pagës. Kjo vlerë hiqet nga paga e punëtorit.

Se sa është numri i punëtorëve pa kontratë në Kosovë nuk dihet. Kosova nuk ka ndonjë mekanizëm që mat nivelin e ekonomisë joligjore, ku bëjnë pjesë edhe punëtorët e paregjistruar dhe ata që shmangin tatimet. Por, në raporte të ndryshme ndërkombëtare vazhdimisht theksohet se ekonomia joligjore në vend përbën më shumë se 30 për qind të brutoprodhimit të brendshëm. Për ta zvogëluar numrin e punëtorëve të paregjistruar, Qeveria e Kosovës ka dalë në muajin korrik me skemën "Qeveria për familjet".

Në bazë të kësaj skeme çdo person nga mosha 18 deri në 65



vjeç, që nuk ka asnjë të punësuar në familje, mund të aplikojë për punë, ndërsa bizneset që i punësojnë ata, subvencionohen nga qeveria. Qeveria subvencionon pagë deri në 300 euro, edhe pse ajo mund të jetë më e lartë.

Paga mesatare bruto në Kosovë është rreth 480 euro.

REL ka pyetur në Ministrinë e Financave të Kosovës se a ka dhe sa është numri i këtyre aplikuesve për punë, por nuk ka marrë përgjigje.

Reformimi i skemave sociale

Qeveria e Kosovës ka nxjerrë më herët një koncept-dokument për reformimin e skemave sociale, ku ka vlerësuar se kriteri që përfituesit e tyre të mos kenë asnjë familjar të punësuar "ka efekt negativ".

"Shumë përfitues të skemave sociale nuk mund ta përballojnë koston e jetesës nëse nuk punojnë, prandaj ata janë të detyruar të punojnë në ekonominë joformale", thuhet në këtë dokument.

Në bazë të tij mësohet se janë duke u diskutuar disa alternativa, për të përfituar edhe familjet që kanë të punësuar, por që nuk arrijnë t'i

mbulojnë shpenzimet e shportës së konsumit.

Në një deklaratë të shkurtër për REL-in, nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Kosovës thonë se "ndihma sociale mendohet të jetë si formë shtesë për t'i plotësuar nevojat ushqimore të familjes". Megjithatë, nuk është e qartë se kur do të mund të realizohet në praktikë reformimi i sistemit të ndihmës sociale.

Projekti për këtë qëllim duket se ka mbetur peng i një kredie në vlerë prej 47 milionë eurosh, që Qeveria e Kosovës e ka nënshkruar me Bankën Botërore në tetor të vitit të kaluar.

Kjo kredi, dy herë radhazi, nuk ka arritur të kalojë në Kuvendin e Kosovës. Sipas deputetëve të opozitës, kredia për paga ose asistencë sociale "është kundër logjikës fiskale". Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë në një deklaratë të mëhershme se projekti për reformimin e ndihmës sociale do të krijojë mekanizma që i ndihmojnë familjet në nevojë të dalin nga varfëria, duke u siguruar atyre ndërlikime me tregun e punës.

Të dhënat e fundit të Bankës Botërore për varfërinë në Kosovë janë të vitit 2017 dhe,

sipas tyre, mbi 23 për qind e qytetarëve të Kosovës jetojnë në varfëri.

Përfituesit nga skemat sociale

Kosova me 1.7 milion banorë ka 15 skema sociale e pensionale, nga të cilat përfitojnë mbi 400 mijë qytetarë. Përveç qytetarëve të papunë dhe me vështirësi ekonomike, nga skemat sociale përfitojnë edhe familjarë të dëshmorëve, veteranë të luftës, pensionistë të moshës etj.

Numri i familjeve përfituese të asistencës sociale në muajin gusht ka qenë rreth 25 mijë, me rreth 100 mijë anëtarë, tregojnë të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Shuma e rregullt që marrin këto familje sillet nga 60 deri në 180 euro në muaj, varësisht nga numri i anëtarëve.

Për këtë kategori nga buxheti i shtetit shpenzohen mesatarisht 32 milionë euro në vit. Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore kanë kritikuar shpesh skemat sociale të Kosovës, duke thënë se ato mund ta fusin vendin në krizë fiskale.

Kosova e ka Ligjin për Skemat e Ndihmës Sociale qysh në vitin 2007.

ATK-ja publikon broshurën "Karta e tatimpaguesit"

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), me qëllim që t'i njoftojë të gjithë tatimpaguesit lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre, ka publikuar broshurën "Karta e tatimpaguesit".

Karta e tatimpaguesit është përgatitur në formë të një udhëzuesi të thjeshtë, gjithëpërfshirës dhe sqarues, për ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme në mes të Administratës Tatimore të Kosovës dhe tatimpaguesve,

bazuar në besim dhe respekt të ndërsjellë.

Përmes këtyre marrëdhënieve synohet të rritet përmbushja vullnetare, duke i trajtuar të gjithë tatimpaguesit në mënyrë të barabartë dhe pa paragjykim, duke i qartësuar gjërat sa më shumë që të jetë e mundur dhe duke qenë transparent e të përgjegjshëm në marrëdhëniet e ATK-së me tatimpaguesin, si dhe në ofrimin e shërbimeve në mënyrë efektive dhe efikase. "Karta e tatimpaguesit është një

udhëzues në të cilin paraqiten të drejtat dhe detyrimet e tatimpaguesit. Andaj, qëllimi ynë është t'i prezantojmë të drejtat dhe obligimet e tatimpaguesve, ashtu që tatimpaguesit të kenë besim në drejtësinë dhe paanësinë e sistemit tatimor, por edhe të jenë në dijeni për implikimin e mospërmbushjes", ka njoftuar ATK-ja.

Karta e tatimpaguesit është përkrahur nga programi i USAID-it për qeverisje ekonomike në Kosovë.



Si pritet të ndryshojë politika e jashtme italiane, pas fitores së Xhorxhia Melonit



Nga Stefano FOLLI

Italia u zgjua shumë ndryshe këtë herë. Fytyra e saj politike është transformuar brenda pak orësh dhe si asnjëherë më parë gjatë dekadave të fundit. Ne ende nuk e dimë nëse ka ndryshuar edhe fati i saj si komb në Evropë. Por kjo është pyetja e parë, që shumë të tjerë e kanë në mendje.

Në realitet, fati i të gjithë protagonistëve dhe aktorëve mbështetës të këtij transformimi historik ndryshon nga sot, ku për herë të parë një parti që nuk e njihnte veten, mbi 70 vjet më parë, në paktin që i dha jetë Republikës aktuale, arrin të fitojë shumicën relative të votave dhe vendeve në parlament.

Rrjedhimisht, tashmë jemi përballë një faqeje boshe, e cila do të duhet që të plotësohet shpejt, pasi recesioni ekonomik po afron dhe kriza ndërkombëtare na kërcënon nga shumë afër. Por në radhë të parë është me vend të pyesim se çfarë do të ndodhë me ardhjen në krye të vendit të

Xhorxhia Melonit, fitueses së vërtetë të zgjedhjeve.

Pasi fitoi ajo dhe jo një koalicion që doli i dërrmuar nga këto zgjedhje dhe ku humbësit quhen Silvio Berlusconi dhe Mateo Salvini. Tani udhëheqësja e re e një të djathtë radikale dhe të opozitës së vetme ndaj qeverisë Dragi – kishte edhe të tjerë të nënkuptuar, për të mos thënë hipokritë – përballat me një test pjekurie për të cilin ajo duhet të jetë shumë e ndërgjegjshme. Me fjalë të tjera: nëse ashpërsia e disa pozicioneve (votimi në favor të Orban, qasja kritike ndaj BE-së etj), ishte një lloj dinakërie elektorale për të forcuar konsensusin midis LEGA-s dhe mbështetësve të Italexit, ne kemi arsye të ndihemi vërtet të qetë.

Por nëse, nga ana tjetër, ato ishin paranteza e një programi hiperpopulist, atëherë ka shumë arsye për t'u shqetësuar. Për më tepër, ne e dimë që pikënisja e Melonit në politikë është një atlantizëm i dukshëm, që sot përkthehet në linjën pro-ukrainase dhe anti-Putin.

Kësaj iu shtua edhe mbrojtja e Tajvanit nga synimet kineze, me argumente që me siguri do t'i pëlqejnë edhe Departamentit Amerikan të Shtetit. Ashtu si Polonia, edhe Italia e partisë së Melonit paraqitet si shumë miqësore me Amerikën, dhe në të njëjtën kohë shumë e ftohtë ndaj Bashkimit Evropian.

Por Italia nuk është Polonia. Ajo është një vend themelues i Evropës politike. Po ashtu nuk ka arsye të kujtohet se sa e ndryshme është historia, pesha, forca ekonomike e secilës. Është krejtësisht logjike të thuhet që ky atlantizëm, i dobishëm për të përfutur të paktën mos-armiqësinë e Uashingtonit, është një kusht i domosdoshëm, por jo i mjaftueshëm për qeverisjen e vendit.

Është e vërtetë që në një artikull të orëve të fundit "Wall Street Journal" e cilëson drejtuesen e Fratelli D'Italia si një politikane konservatore që nuk ndryshon nga të tjerët që janë shfaqur më herët në skenën evropiane, duke e mbyllur me fjalën: "Tek e fundit,

ajo nuk është Marinë Lë Pen".

Në fakt duhet shtuar se ajo nuk është si Margaret Theçer. Pikërisht për këtë arsye, ana tjetër e medaljes, pra marrëdhënia e saj me BE-në, por mbi të gjitha me Parisin dhe Berlinin, meriton një lloj sqarimi. Në lidhje me Ukrainën dhe Rusinë, Xhorxhia Meloni shfaqet në harmoni me Mario Dragin, kryeministrit në ikje, të cilit ia ka mohuar gjithmonë votat në parlament, edhe pse ka ruajtur një marrëdhënie korrekte institucionale.

Por fakti është se ajo ka një distancë të dukshme në Bashkimin Evropian. Aq sa kryeministri në largim donte të kujtonte ditë më parë se marrëdhëniet tona më të rëndësishme nuk janë me Orban, por me Makron dhe Sholc. A është në gjendje kryeministria aspirante, gruaja e parë në historinë italiane, që ta hedhë këtë hap pa humbur trashëgiminë e Dragit?

A është ajo e aftë të pranojë këshillat e këtij të fundit, që i njej prestigjin, duke pranuar se është

në interesin e qeverisë së re italiane të përdorë besueshmërinë e saj në avantazhin të një klase sunduese që ka ende gjithçka për të provuar? Kjo qasje supozon që shumica e krahut të djathtë, në të cilën Meloni është dominante, ndërsa Salvini dhe Berlusconi janë reduktuar në aktorë mbështetës, është e aftë që të largohet nga porti pa u përplasur me kalatën.

Tek e fundit, gjithçka mbetet të provohet. Paqartësitë e së djathtës në lidhje me politikën e jashtme janë të pamohueshme. Dhe për një Meloni pro-perëndimore sfidë mbeten bluzat me fytyrën e Putinit të veshura nga Salvini, por edhe miqësia e rrezikshme të Berlusconi me presidentin rus. Në letër, kandidatja për kryeministre i ka votat dhe vendet në parlament, dhe me to do t'i paraqitet presidentit Matarella. Por rruga për të është e gjatë dhe gjarpëruese. Ajo do të duhet të ruajë meritat që i ka dhënë Italisë Mario Dragi muajt e fundit. Dhe për ta bërë këtë nuk do të mjaftojnë sloganet elektorale. /"La Repubblica" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Infantino sot vjen në Kosovë



"Epoka e re"

PRISHTINË, 29 SHTATOR - Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, sot (e premte) do të vizitojë Kosovën me ftesë të kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi. Në fakt, numri një i FIFA-së të enjten e ka vizituar Shqipërinë, ku është takuar me kryeministrin Edi Rama dhe kryetarin e Federatës Shqiptare

të Futbollit, Armand Duka. Ndërsa në Kosovë Infantino do të ketë takim me drejtuesit e institucioneve shtetërore të Kosovës, presidenten Vjosa Osmani, kryeministrin Albin Kurti, ministrin e Sportit, Hajrulla Çeku dhe kryetarin e komunës së Prishtinës, Përparim Rama. "Pas takimeve me drejtuesit e FFK-së, me komunitetin e futbollit dhe me krerët e institucioneve shtetërore, kryetari Agim Ademi dhe presidenti Gianni Infantino do t'u

drejtohen medieve. Deklarata për medie e dy presidentëve rreth kësaj vizite historike do të bëhet në orën 15:00 në selinë e FFK-së", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës. Që nga anëtarësimi i Kosovës në FIFA, Infantino ka qenë mbështetës i të gjitha projekteve në të cilat ka aplikuar FFK-ja në programet investuese të FIFA-s, prandaj vizita e tij dëshmon simpatinë dhe respektin që ai ka për Kosovën.

UEFA: Kosova nuk mund të jetë në një grup me Serbinë dhe Bosnjën



FRANKFURT, 29 SHTATOR - Para hedhjes së shortit kualifikues për Kampionatin Evropian 2024, i cili është planifikuar më 9 tetor në Frankfurt, UEFA ka njoftuar për disa rregulla dhe përditësime. Sa i përket Kosovës, UEFA ka njoftuar se kombëtarja nuk mund

të caktohet në një grup me Serbinë apo Bosnjë e Hercegovinën për arsye politike. "Këto çifte nuk duhet të përfshihen në të njëjtin grup: Armenia/Azerbajxhani, Bjellorusia/Ukraina, Gjibraltari/Spanja, Kosova/Bosnjë dhe Hercegovina dhe

Kosova/Serbia", thuhet në njoftimin e UEFA-s. Kosova gjendet në vazon numër 4, bashkë me Gjeorgjinë, Greqinë, Turqinë, Kazakistanin, Luksemburgun, Azerbajxhanin, Bullgarinë, Ishujt Faroe dhe Maqedoninë e Veriut.

SHKURT

Kuvendi miraton Projektligjin për Anti-Doping

Kuvendi ka miratuar në lexim të parë Projektligjin për Anti-Doping, i paraqitur nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku. Prej 67 deputetëve të pranishëm, të gjithë kanë votuar për. Çeku ka thënë se ky projektligj parasheh rregullimin e fushës së Anti-Dopingut në sportin e Kosovës, i cili ka tri objektiva: "Fuqizimi i integritetit të sistemit sportiv në Kosovë; kujdesi i shëndetit të sportistëve në Kosovë; sigurimi i drejtësisë dhe shanseve të barabarta në gara sportive", ka thënë Çeku.

Napoli mendon t'ia vazhdojë kontratën Rrahmanit deri më 2027

Kapiteni i Kosovës në futboll, Amir Rrahmani, duket se do të luajë edhe për një kohë të gjatë në Napoli. Mbrojtësi shtatlartë është afër vazhdimin të kontratës me klubin italian. 28-vjeçari është bërë prej lojtarëve kryesorë të trajnerit Luciano Spalletti, ndërsa këtë sezon i ka zhvilluar tetë ndeshje deri tash me ekipin italian. Napolitanët duan ta vazhdojnë bashkëpunimin me qendërmbrojtësin deri në vitin 2027, ndërsa planifikojnë edhe t'ia rrisin rrogën atij. Rrahmani ka luajtur gjatë karrierës së tij për Drenicën, Partizanin e Tiranës, Splitin, Dinamo Zagrebin, Lokomotiv Zagrebin dhe Veronën.

Ismajli humb ndeshjen ndaj Milanit

Mbrojtësi i kombëtares së Shqipërisë, Ardian Ismajli, do të mbetet për disa javë jashtë fushës së blertë për shkak të lëndimit që pësoi në ndeshjen me kombëtaren kuqezi. "Tuttomercatoweb" ka shkruar të enjten se te Empoli po frikësohet se lëndimi i Ismajlit mund të jetë më serioz dhe do t'i duhet kohë më e gjatë për t'u rikuperuar. Sot (e premte) Ismajli do t'u nënshtrohet kontrollimeve shtesë për ta konfirmuar diagnozën e saktë. Mbrojtësi do ta humbasë ndeshjen kundër Milanit që Empoli e zhvillon të shtunën.

Irvingu: Refuzova 100 milionë dollarë, shkak vaksina kundër Covidit

BROOKLYN, 29 SHTATOR - Gjatë konferencës për shtyp para fillimit të edicionit 2023-2023, Kyrie Irving, ylli i Brooklyn Netsit, ka rrëfyer peripecitë që përjetoi në vitet e fundit, kur nuk luante pasi ishte i pavaksinuar. "Hoqa dorë nga një rritje e ndjeshme e rrogës,

nga një kontratë katërvjeçare me vlerën e 100 milionë dollarëve, për të mos u vaksinuar. Mora një vendim për të mos marrë vaksinën anti-Covid, duke mos e ditur nëse do të luaja më në NBA apo jo", ka thënë Irvingu. "Ndoqa këtë rrugë dhe mora këtë

vendim i vetëdijshëm për atë që po bëja. E dija që rrezikoja vendin e punës. Mund të kisha një marrëveshje pa nisur sezoni i kaluar, por për shkak se nuk e mora vaksinën gjithçka dështoi. Ishte një kafshatë e hidhur për t'u kapërdirë", ka shtuar Irvingu.



Tre kandidatët e mundshëm për pasardhës të Rejës



TIRANË, 29 SHTATOR - Presidenti Armand Duka apo FShF-ja nuk e kanë zyrtarizuar ende largimin e trajnerit Edi Reja, edhe pse pritet largimi i trajnerit italian i cili kërkon një ndarje paqësore me italianin, sepse ai është ende nën kontratë dhe i përfundon më 26 nëntor. Madje flitet që 76-vjeçari, më saktë 77, pas datës 10 tetor, do të qëndrojë për t'i drejtuar edhe dy miqësoret, me Arabinë Saudite dhe Italinë. Në anën tjetër kanë filluar spekulimet

për emrat e kandidatëve për stolin e Shqipërisë që pritet ta zëvendësojnë Edi Rejën.

Xhankarlo Kamoleze është një prej tyre për vetë faktin që ka qenë edhe më përpara duke mbajtur postin e drejtorit teknik të ekipeve kombëtare dhe ka mbikëqyrur nga afër gjithë situatën. Ai është larguar së fundmi nga ky post dhe FShF-ja nuk ka dhënë ndonjë arsye për këtë largim. Një tjetër opsion është Besnik Hasi, i cili mbetet "kandidati

i përjetshëm" për këtë post. Një ish-kapiten kuçezi që aktualisht është pa ekip dhe më parë ka drejtuar skuadra si Anderlecht, Olimpiakos apo Legian e Varshavës. Një tjetër alternativë që spekulohet është mundësia e rikthimit të Gianni de Biasit, trajnerit të suksesshëm që arriti të kualifikohet me Shqipërinë në "Euro 2016". Edhe pse ai është trajner i Azerbajxhanit, me ofertën e duhur mund ta shohim edhe një rikthim të bujshëm.

Reali, gati 215 milionë euro për dy yjet e Cityt



MADRID, 29 SHTATOR - Real Madridi po planifikon të hidhet në sulm për dy yjet e Manchester Cityt, Joao Cancelo dhe Erling Haaland, raporton "Diario AS". Haaland sapo mbërriti në Premierë Ligë, por "Los Blancos" e sheh atë si zëvendësues të Karim Benzemas në verën e vitit 2024. Ndërkohë, Cancelo do të ishte një objektivi për verën e ardhshme. Mbrojtësi portugez

është kthyer në një nga më të mirët në pozicionin e tij në botë nën drejtimin e Pep Guardiolas dhe Real Madridi dëshiron ta joshë atë të kthehet në Spanjë, ku ai luajti për Valencian në fillim të karrierës së tij. Në përgjithësi, Real Madridi ka bërë një blerje të madhe çdo verë gjatë viteve të fundit dhe kjo do t'i përshtatej asaj politike. Megjithatë, nëse ata vendosin të bëjnë një

ofertë për Jude Bellingham, i cili ka qenë i lidhur me Madridin për verën e ardhshme, kjo do të nënkuptonte një largim nga strategjia në vitet e fundit. Duke qëndruar te dyshja Haaland-Cancelo, do të bëjë fjalë për një operacion shumë të kushtueshëm. Norvegjezi ka një vlerë prej 150 milionë eurosh në merkato, ndërsa portugezi vlerësohet 65 milionë.

SHKURT

Asllani: Jam gati ta zëvendësoj Brozoviçin

Kristjan Asllani nuk u aktivizua në asnjë minutë në sfidën e fundit ndaj Islandës, por kjo nuk do të thotë se nuk është gati për të luajtur tek Interi. Ai me shumë mundësi do të jetë titullar kundër Romës pas dëmtimit të Marcelo Brozoviçit. Në një intervistë të dhënë për mediet italiane ai është shprehur se do të jetë gati për ta dhënë kontributin e tij. "Sa keq që Brozoviçi është dëmtuar, një lojtar themelor për ne, por nëse vjen radha ime tashmë, unë jam gati. Do të përpiqem të jap më të mirën time", tha talenti shqiptar për "Tuttosport".

Llorente: Në Real do të shkoja falas

Fernando Llorente, sulmues që ka luajtur për Bilbaon, Juventusin, Sevillen, Swansean, Tottenhamin, Napoli e të tjera skuadra, kampione bote dhe Evrope me Spanjën, i ka bërë një retrospektivë karrierës së tij në një intervistë për programin "El Larguero". Ai ka shprehur pengun e tij për të luajtur me Realin e Madridit. "Ka qenë ëndërr për mua të luaja për Realin. Në fakt, nuk kam qenë kurrë atje. Sa herë që më donte Reali, unë isha nën kontratë me Atleticon e Bilbaos. Edhe kur më përfundoi kontrata me Bilbaon, Juventusin u tregua më i shpejtë. Ajo ishte mundësia ime më e mirë për të shkuar në Madrid. Do të shkoja falas, mjafton të isha zëvendësi i Benzemasë", ka thënë Llorente.

Operohet Ozili, rikthehet pas tre muajsh


Mesfushori Mesut Ozil ka vendosur t'u japë fund problemeve në shpinë. Fantazisti turko-gjerman e ka ndarë mendjen dhe ka kryer një ndërhyrje kirurgjikale që do ta mbajë jashtë fushave të blerta për rreth 3 muaj. Kjo është një mungesë e madhe për ekipin e Basaksehirit dhe trajnerin Emre Belozoglu, me mesfushorin ofensiv që pritet të rikthehet në vitin 2023. Basaksehiri renditet për kohësisht në vend të tretë në kampionatin turk, ndërkohë që po garon edhe në Ligën e Konferencës, aty ku ka fituar dy sfidat e para në grupin A (Hearts, Fiorentina).

Tri klub angleze e dëshirojnë Mbappen

Reprezentuesi i Francës, njëherësh anëtar i PSG-së, Kylian Mbappe, është në listën e tri skuadrave angleze. Ylli francez mund të largohet nga Parisi në vitin 2024, një mori klubesh të Premierë Ligës kanë shprehur qysh tash interesim për sulmuesin. Mediet raportojnë se ish-sulmuesin e Monacos e dëshirojnë Manchester Unitedi, Liverpools dhe Chelsea.

Liverpools e nxjerr në shitje Firminon

Roberto Firmino do të largohet nga Liverpools pas shtatë vjetësh qëndrim në "Anfield". Sulmuesi brazilian iu bashkua gjigantëve anglezë në verën e vitit 2015 nga Hoffenheim për 41 milionë euro dhe që nga ajo kohë ka qenë një futbollist shumë i rëndësishëm. Por vitin e fundit braziliani ka humbur vendin e titullarit dhe tanimë është futur në vitin e fundit të kontratës me "The Reds". Gjiganti anglez i ka ofruar rinovimin, por Firmino e ka refuzuar atë pasi dëshiron një aventurë të re. 30-vjeçari është nxjerr në shitje nga "The Reds" pasi duan të fitojnë diçka nga largimi i tij në janar, pasi në verë do ta humbasë falas. Reprerentuesi brazilian ka tre opsione për ta vazhduar karrierën e tij, në Spanjë, në Itali apo një rikthim në Gjermani.


REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:179544
Datë: 16.09.2022
Numri i dokumentit: 03380592

C.nr.553/2020

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC, e përbërë nga gjykatësi Betim Behluli, në çështjen juridike të paditësit Islam Hoti nga fshati Ratkoc, komuna e Rahovecit të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati Qazim Qeska nga Rahoveci, kundër të paditurit Dul Morina nga fshati Ratkoc, komuna e Rahovecit, tani me adresë të panjohur, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të fitimit me parashkrim, më 16.09.2022, morri këtë:

A K T V E N D I M

Të paditurit Dul Morina nga fshati Ratkoc, komuna e Rahovecit, tani me adresë të panjohur, i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm avokati Zyber Zeka nga Rahoveci.

Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht derisa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Ky aktvendim do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në një nga gazetatat e përditshme ditore, si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

A r s y e t i m

Paditësi Islam Hoti nga fshati Ratkoc, komuna e Rahovecit, kësaj gjykate i ka ushtruar padinë kundër të paditurit Dul Morina nga fshati Ratkoc, komuna e Rahovecit, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të fitimit me parashkrim.

Gjykata të paditurit Dul Bajram Morina i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi të paditës 08.11.2021, por nga fletë kthesa e postierit konstatohet se palë është e panjohur në këtë fshat. Gjykata më aktvendimin e datës 15.12.2021 e ka obliguar paditësin që të sigurojë adresën e saktë për të paditurin.

Në bazë të parashtrës së autorizuarit të paditësit avokati Qazim Qeska e datës 22.12.2021 në harmoni me aktvendimin e datës 15.12.2021 i propozon gjykatës që të caktoj përfaqësuesin e përkohshëm për të paditurin. Pasi i është dorëzuar me emrin Dul Morina vendbanimin e fundit e ka pasur në fshatin Ratkoc dhe si paditësi nuk kanë mundësi për të siguruar adresën e vendqëndrimit të të paditurit.


Numri i lëndës: 2020:179544
Datë: 16.09.2022
Numri i dokumentit: 03380592


kata për të vërtetuar saktë pretendimet e paditësit, me parashtrës i është drejtuar Policisë së Kosovës dhe të njëjtit me parashtrësën e datës 13.09.2022 e kanë njoftuar gjykatën se pas aktit me disa qytetarë të fshatit Ratkoc i janë përgjigjur se nuk e njohin personin me këtë...

Duke vendosur sipas propozimit të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, gjykata gjeti të plotësuar kushtet nga neni 79.3 të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurës dhe se përfaqësuesi i përkohshëm avokati Zyber Zeka nga Rahoveci, është pajtuar përfaqësojë të paditurën e lartcekur në këtë çështje juridiko - civile.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA RAHOVEC,
C.nr. 553/2020, më, 16.09.2022


GJYKATËSI
Betim Behluli


REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
C.nr. 65/19
Më dt. 20.09.2022
Prishtinë

Njoftim për përkthim të aktvendimit C.nr. 65/19, të datës 20.09.2022

Paditësi Lutfi Hoxha nga Prishtina, ka parashtruar padi për vërtetimin e pronësisë, kundër të paditurës Shoqëria Aksionare, Ndërmarrja Tregtare Qarkulluese me pakicë dhe shumicë "Nish Promet", Obrenovc, Nr. 42, tani me adresë të pa njohur.

Gjykata ka nxjerrë aktvendim C.nr.65/19, të datës 20.09.2022, me të cilin të paditurës i ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm. I njëjti aktvendim duhet të publikohet në Gazetën Zyrtare dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës, në gjuhën angleze dhe serbe. Për këtë arsye ftohet paditësi që aktvendimin C.nr. 65/19, të datës 20.09.2022, ta përkthejë në gjuhën serbe dhe angleze dhe të njëjtin t'ia sjellë gjykatës në kopje të mjaftueshme, në mënyrë që gjykata të ndërmerr veprime të mëtejme.

Gjyqtarja
Ujvësë Hysenaj

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Enver Peci shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".
- Rima Engineering Group" SH.P.K. shpall tw pavlefshme certifikatën e TVSH-sw, me nr 330270116.
- Marjeta Laksi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII të SH.M. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Sabri Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f. "Shaban Golaj" Lipovec Gjakovë.
- Flora Xhuli nga Juniku shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII të gjimnazit "Edmond Hoxha" Junik.
- Masters BR-DOO. Shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues 811935230.
- Blerim B. Bajrami B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit individual me emrin tregtarë D.P.Z. Auto Ngjyrosës "Buli" me nr. Unik 810934580.
- "Trend Shped" SH.P.K. shpall të pavlefshme Polica e sigurisë së kamionit TPL 0009532850 TPL PLUS 0002214215.
- Shield Recruitment&HR SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811277343
- Hana Nuha shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme të vitit I, II, III me nr: 1130 të vitit 2000, 1594 të vitit 2001 si dhe 2128 të vitit 2002 drejtimi Elektro Teknik "Naim Frashëri".
- Larta Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Njëmbëdhjetë të Gjimnazit "Eqrem Çabej" Prishtinë.
- Kolë Vokrraj nga Novosella e Epërme kk Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Kushtrim Hoxha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales